



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 3.12.2018, ora 11.30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi dhe miratimi i kalendarit të punës së Komisionit për muajin dhjetor 2018.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Fate Velaj, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Sezai Rrokaj.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëdita të gjithëve!

Sot në mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik do të diskutojmë dhe miratojmë kalendarin e punës së komisionit për muajin dhjetor.

Fillimisht të diskutojmë vizitat e punës së komisionit në disa muze të vendit.

Duke patur parasysh që ky vit është shpallur si Viti Mbarëkombëtar për Skënderbeun, mendojmë ta fillojmë me një vizitë në Muzeun Historik “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, në Krujë. Po në vijim të kësaj të organizojmë një vizitë në Muzeun Historik Kombëtar, këtu në Tiranë.

Një tjetër muze që duhet të vizitojmë, duke pasur parasysh që këtë vit është miratuar edhe ligji i ri “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, është Muzeu Arkeologjik i Durrësit.

Çështjet që do të diskutojmë, siç bëjmë edhe në vizitat e Komisionit në Butrint dhe Kalanë e Gjirokastrës, në datat 23 dhe 24 nëntor, do të jenë pak a shumë këto: Numri i vizitorëve dhe ndikimi i tij në rritjen e të ardhurave; ligji i ri “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”; propozime mbi planifikimin e përdorimit të të ardhurave; marrëdhënia me njësitë e qeverisjes vendore; marrëdhënia me organizatat ndërkombëtare; sfidat më të rëndësishme për vitin e ardhshëm etj..

Gjithashtu, prej kohësh kemi vendosur të bëjmë një vizitë pune edhe në Institutin e Zhvillimit të Arsimit, IZHA, me drejtor Gerti Janaqin, të cilën e kemi përmendur kur z. Janaqi ka qenë në mbledhjen e Komisionit me Ministren e Arsimit, znj. Nikolla.

Si mendoni, në çfarë datash t’i lëmë këto vizita?

Musa Ulqini – Meqë, duke u nisur nga axhendat tona, këtë periudhë e kemi shumë të ngarkuar, mendoj që vizitat në muzetë e Krujës dhe Durrësit t’i kryejmë brenda një dite.

Milva Ekonomi – Mirë, atëherë propozoj këtë axhendë:

Më datë 4 dhjetor:

- vizitë pune e Komisionit në Muzeun Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Krujë,
- vizite pune e Komisionit në Muzeun Arkeologjik, Durrës.

Më datë 5 dhjetor:

- vizitë pune e Komisionit në Muzeun Historik Kombëtar,

- vizitë pune e Komisionit në Institutin e zhvillimit të Arsimit, IZHA.

Për orën, të shikojmë se kur na volit të nisemi.

A jeni dakort?

Komisioni shprehet dakort me propozimin.

Ndërkohë, duhet të kemi parasysh që duhet të jemi të gjithë, pasi na duhet kuorumi dhe deputetët zëvendësues nuk na përgjigjen dot.

Një çështje tjetër është edhe ajo e z. Bregu, anëtari i AMA-s, me të cilin tashmë e kemi bërë seancën dëgjimore. Tani presim materialin nga këshilltarët, që të shikojmë se kur do të caktojmë datën e mbledhjes.

Në adresë të Komisionit ka ardhur dhe një shkresë e AMA-s, me kërkesën për të organizuar një takim të përbashkët në vijim të diskutimeve mbi rregullimin ligjor në marrëdhëniet e punës së gazetarëve në transmetimet audiovizive.

Si mendoni për këtë, e lëmë për në janar?

Atëherë, e mbyllim këtu, duke ju falenderuar.

